Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e pranimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Sahit Beqiri	**27.03.2024**	**06.04.2024**	**2024/0249**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

(Të përshkruhen dispozitat e shkelura dhe vetëm pikat e ankese)

Me datën: **21.03.2024**, GOE: **PRIME CORPORATION L.L.C.; Erzeni Sh.p.k.- Malishevë**, ka parashtruar ankesë me nr: **2024/0249**, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë GOE: **Wood Corporation L.L.C.; Madekos Sh.p.k. - Suharekë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Furnizim me mobilje"** me nr. të prokurimit: "**UA/2016-23-14297-1-1-1"**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) **– Agjencia Qendrore e Prokruimit.**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: **furnizim,** vlera e parashikuar e kontratës: **Lot 1: 185,000.00€; Lot 3: 2,250,000.00 €**.€.Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë NUK është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

(Të përshkruhen dispozitat e shkelura dhe vetëm pikat e ankese)

Neni 1 Qëllimi

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Si dhe nuk ka vepruar në përputhje me Rregulloren nr. 001.2022 për Prokurimin Publik

konkretisht në nenet si në vijim: N**eni 40 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve**

<u>Deklarata detale mbi faktet dhe argumentet</u>

Ne konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues (AK), Agjencia Qendrore e Prokurimit nuk ka vepruar në përputhje me nenin 1, 7, 27 dhe nenin 59 të LPP-së si dhe me nenin 40 të Rregullorës nr. 001.2022 për Prokurimin Publik.

Pretendimi ankimor 1:

Në kundërshtimin me nenin 1, paragrafi 1 dhe nenin 7, paragrafi 1dhe paragrafi 2, Autoriteti Kontraktues (AK), Agjencia Qendrore e Prokurimit, bazuar në rregullat të cilat i ka përcaktuar nuk ka trajtuar në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese të gjithë Operatorët Ekonomik, pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit.

Fakte:

Autoriteti Kontraktues ka shpërblyer me kontratë një operator ekonomik i cili nuk është I përgjegjshëm. Me këtë veprim AK ka eliminuar konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik, duke vepruar në dëm të kompanisë tonë dhe në të mirë te një operatori tjetër.

Pretendimi ankimor 2:

AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 59, paragrafi 1 dhe paragrafi 4 si dhe në kundërshtim me nenin 10, paragrafin 40.7 dhe paragrafin 40.13 të Rregullorës nr. 001.2022 për Prokurimin Publik, bazuar në kriteret që ka përcaktuar në FDT, pika 9.1 &9.2 (Kërkesa numër 1 dhe 2), Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale.

Fakte:

AK nuk ka vlerësuar në pajtim me kërkesat që ka përcaktuar në Dosjes së Tenderit, FDT, pika 9.1 & 9.2, Kërkesa mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale numër 1. Grupi i Operatorëve Ekonomik të cilat janë shpallë fitues nuk kanë ofruar dëshmi të mjaftueshme se kanë përfunduar me sukses furnizime të natyrës së ngjashme për tri vitet e fundit në vlerë prej 3,000,000.00 €. Anëtari i grupit të konzorciumit MADEKOS, në referencat e tij ka ofruar produkte medicionale dhe pajisje medicionale, sic edhe është veprimtaria e tij. Referuar një vendimi të AK të datës 20.04.2021 të një njoftimi mbi vendimin e AK-së, shihet se AK-ja ka vepruar në veprim kontradiktor ndaj veprimeve të veta. Në këtë vendim shihet qartë se po e njëjta kompani, MADEKOS, me një aktivitet të njëjtë të prokurimit "Furnizim me inventar zyrtar dhe shkollor", shihet se është eliminuar për shkak se nuk i janë pranuar referencat medicionale, apo inventari mendicional. (gjeni bashkangjitur dëshminë). Po ashtu "Wood

Coporation" në dokumentacionin e bashkangjitur si dëshmi e furnizimeve të ngjashme shihet se një referencë në vlerë prej 70,000.00 € është dëshmuar dy herë, duke vënë në lajthitje AK-në.

AK po ashtu nuk ka vlerësuar në pajtim me kërkesat që ka përcaktuar në Dosjes së Tenderit, FDT, pika 9.1 & 9.2, Kërkesa mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale numër 2. Citoj: "Dëshmia 2 Katalogu për produktet qe oferton - Katalogu duhet të jetë i sakët për produktet që ofertoni. Nuk lejohet të ketë opsione si minimum apo duhet të ketë..., pra nuk mund të shfrytëzohet Aneksi 1 i dosjes së tenderit si katalog por duhet të ofrohet katalog që përfshinë të gjitha specifikat e produktit të cilin e ofroni". Po të njëjtit së bashku me ofertë në kundërshtim më kërkesën 2 të pikës 9.1 & 9.2 të FDTsë, kanë dorëzuar të nënshkruar dhe vulosur edhe specifikimin teknik edhe katalogun, kërkesë kjo e ndaluar nga AK-ja.

Në katalog shihet që disa nga pozicionet nuk janë të harmonizuara fotot me përshkrim, si dhe tek pozicioni 35 është përdorë "dhe të ketë", gjë që është e ndaluar si shprehje nga vet AK-ja. Po ashtu tek pozicioni 1, 2, 3, 4, 5, dhe 6 mungon titulli i pozicionit sipas specifikacionit teknik.lidhur me këtë procedure tenderuese, kërkojmë qe AK-ja të bëjë anulimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues dhe ta kthej lënden në rivlerësim – rivendosje.

letra standarde per tenderuesin e eleminuar si arsye e referencave te veprimtarive tjera, si paisje apo produkte tjera medicinale.

B42 - Letër standarde për tenderuesin e eliminuar

20.04.2021 , Prishtinë
Agjencia Qendrore e Prokurimit

Grup i Operatorëve Ekonomik: Ndërmarrja Tregtare Grafike Blendi O.P.; N.SH.T. MADE-KOS

Nr. i prokurimit:	AQP	2	0	0	0	5	1	1	1

Titulli: Furnizim me inventar zyrtar tavolina pune dhe ormana - Lot 1
Furnizim me inventar zyrtar karrige - Lot 2
Furnizim me Inventar shkollorë, operatorin ekonomik - Lot 3

I nderuar : **Shaip Rama**
Paleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik.
Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP ".
Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në *dosjen e tenderit* .Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:
Tenderi i juaj është administrativisht i papërgjegjshëm:

ARSYETIM

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye :

Pas kontrollimit të ofertës tek lista e projekteve të realizuar kemi vërejtur se e njëjta nuk ka ofruar dëshmi te mjaftueshëm të realizimit të furnizimeve për tri vitet e fundit 218-2019-2020 për LOT 1. Vlera e dëshmuar me fatura dhe referenca është 189,242.00 €, ndërsa kërkesa në dosjen e tenderit ka qenë për Lot 1- 1,2000,000.00 €, Lot 2: 1,000.000.00 € & Lot 3: 5,000.000.00 €. Andaj Komisioni duke u bazuar ne neni 72 te LPP me datën 19.03.2021 ka dërguar letrën standard për sqarim te tenderit duke kërkuar që të sjellim dëshmi shtesë për furnizimet e deklaruara sipas listës se dorëzuar nga ana e Grupit te Operatoreve ekonomi/ofertuesit.
Me datën 24.03.2021 kemi pranuar sqarimet shtesë dhe kemi vërejtur se edhe pas sqarimeve nga Grup i Operatorëve Ekonomik: Ndërmarrja Tregtare Grafike Blendi O.P.; N.SH.T. MADE-KOS nuk ka dorëzuar dëshmi te mjaftueshme për Lot 1.
Sipas listës se dorëzuar për kontratat/ furnizimet e realizuar pas sqarimeve vlera e dëshmuar për furnizime të natyrës se ngjashme është 346,699.00 € .

ne kete fakt shihet se edhe pas sqarimeve nga MADE KOS prap nuk vlejn referencat per paisje mjeksore per ato te Mobiljeve

PËRGJIGJJA:

1. Nga kërkesat për Ri-shqyrtim nuk kemi pretendime ankimore ndaj OE të rekomanduar për fitues për Lot 1: Furnizimi me inventar zyrtar tavolina pune dhe armana dhe mbetet në fuqi vendimi mbi rekomandimin për fitues.
2. Pretendimet ankimore të ofertuesve: Grup i Operatorëve Ekonomik: GRANITI SH.P.K.; ARTOFIS MOBILYA; TRENDY HOME SH.P.K.; Kuk - Commerc SH.P.K.; Grup i Operatorëve Ekonomik: Ndërmarrja Tregtare Grafike Blendi O.P.; N.SH.T. MADE-KOS Grup i Operatorëve Ekonomik; Grup i Operatorëve Ekonomik GALANTERIA SH.P.K.; Rival Pazarlama Dis.Tic.LTD.STI FORUM, Grup i Operatorëve Ekonomik SM COMPANY; Sh.p.k; BENI - COM SH.P.K.; Sarajevo Business Consulting; ITRO-COOP D.O.O; dhe Grup i Operatorëve Ekonomik: IBM SH.P.K.; Majlinda Bajraktari B.I.; Isak B. Ademi; Elbasan Alidemi B.I. në kërkesat për Ri-shqyrtim janë të pabazuara për Lot 2: Furnizimi me inventar zyrtar karrige pune dhe mbetet në fuqi Vendimi mbi anulimin e Lot 2.

Pretendimet ankimore (dispozitat e shkelura nga AK), janë të njëjta me kërkesa për rishqyrtim në autoritetin kontraktues, kurse tek Deklarata detale mbi faktet dhe argumentet – janë te njëjta me atë të dorëzuar në kërkesën për rishqyrtim pranë AK-së.

KRITERET PËR VLERËSIM

(Të vendosen vetëm kërkesa/kriteret që kanë të bëjnë me arsyet e eliminimit dhe/apo ato kërkesa që lidhen me pretendimet ankimore)

III.2.2) Përshtatshmëriaprofesionale: Dëshmia e kërkuar dokumentar.

Kërkesa 1 Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit;	**Dëshmia 1 Një dokument i lëshuar nga autoriteti përkatës publik në vendin e themelimit të operatorit ekonomik me të cilin evidentohet regjistrimi i operatoritekonomik në atë vend (Kopja e certifikatës së biznesit);**

III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar Dëshmia e kërkuar dokumentar.

Kërkesa 1 Operatori ekonomik duhet të ketë realizuar gjatë tri viteve të shkuara një xhiro totale në EURO minimum Lit 1 350,000.00 Euro Lot 2 1,000,000.00 Euro Lot 3 4,000,00.00 Euro	**Dëshmia 1 Deklaratat Tatimore Vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës për tri vitet e shkuara ose vërtetim të lëshuar dhe vërtetuar nga ATK-ja mbi qarkullimin financiar në tri vitet e shkuara ose gjendje e përgjithshme të lëshuar dhe vërtetuar nga ATK.**

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional Dëshmia e kërkuar dokumentar.

Kërkesa 1 Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses furnizime të	**Dëshmia 1 Operatori Ekonomik duhet te plotësoj formularin standard të dhënë në**

natyrës se ngjajshme në 3 (tri) vitet e shkuara, jo me pak se Lot 1 200,000.00 Euro Lot 2 700,000.00 Euro Lot 3 3,000,000.00 Euro	**Aneksin 8 te Dosjes se Tenderit apo ndonjë format tjetër që përfshinë afërsisht te dhënat e aneksit 8 dhe te bashkëngjis certifikatat përkatëse ose ndonjë dokument tjetër qe evidenton liferimin e tillë, gjithashtu Operatori Ekonomik për plotësimin e kësaj kërkesë mund te bashkëngjisë edhe Listë Libër të faturave të shitjeve (ku duhet të shihet qartë të paktën blerësi, data, artikujt dhe shuma duke ua bashkangjitur faturat si dëshmi) apo edhe duke paraqitur referenca si nga blerësi publik apo edhe nga blerësi privat.**
Kërkesa 2 Katalogu për produktet qe oferton	**Dëshmia 2 Katalogu për produktet qe oferton - Katalogu duhet të jetë i sakët për produktet që ofertoni. Nuk lejohet të ketë opsionie si minimum apo duhet të ketë... , pra nuk mund të shfrytëzohet Aneksi 1 i dosjes së tenderit si katalog por duhet të ofrohet katalog që përfshinë të gjitha specifikat e produktit të cilin e ofroni.**

Aneksi 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

Garancioni për secilin artikull është 12 muaj nga pranimi i mallit.

Devijimi i lejuar në dimension është +- 5 % si për tavolina, dollapë dhe karriga zyrtare. Inventari duhet të jetë komfor specifikimeve teknike të specifikuara më poshtë dhe komfor standardeve.

Fotot janë vetëm për ilustrim, obligative është të plotësohet kërkesat e paraqitura tek "përshkrimi"

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

(Të përshkruhet vetëm vlerësimi i ofertës së OE ankues/ofertave, për të cilat OE ankues ka pretendime ankimore).

Grup i Operatorëve Ekonomik PRIME CORPORATION L.L.C.; Erzeni shpk,., ka plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftim për kontratë, për Lot 1, Lot 2 dhe Lot 3, mirëpo, për shkak së oferta e tyre, për Lot 1 dhe Lot 3, nuk kanë qenë oferta të përgjegjshme me çmimin më të ulët, nuk janë rekomanduar për kontratë.

Lot 2: "Furnizim me karrige" - Grup i Operatorëve Ekonomik PRIME CORPORATION L.L.C.; Erzeni shpk, me vlerë të ofertës 393,190.00€.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

///

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

///

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

///

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

///

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **PRIME CORPORATION L.L.C.**

(Të vendosen vetëm kërkesa/kriteret që kanë të bëjnë me arsyet e eliminimit dhe/apo ato kërkesa që lidhen me pretendimet ankimore)

- Eksperti shqyrtues, pas ekzaminimit të dosjes së tenderit, shqyrtimit të rrjedhës së procedurës së tenderimit dhe pretendimeve të palës në ankesë sqaron me sa vijon:

Përgjigje në pretendimi nr. 1

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues, ne kundërshtimin me nenin 1, paragrafi 1 dhe nenin 7, paragrafi 1 dhe paragrafi 2, Autoriteti Kontraktues (AK), Agjencia Qendrore e Prokurimit, bazuar në rregullat të cilat i ka përcaktuar nuk ka trajtuar në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese të gjithë Operatorët Ekonomik, pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit.

Fakte:

Autoriteti Kontraktues ka shpërblyer me kontratë një operator ekonomik i cili nuk është i përgjegjshëm. Me këtë veprim AK ka eliminuar konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik, duke vepruar në dëm të kompanisë tonë dhe në të mirë te një operatori tjetër.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, bazuar ne dosjen e tenderit, OE ankues ka përshkruar dispozitat ligjore te LPP-së, mirëpo nuk ka specifikuar konkretisht

se me cilat veprime apo/ose ne çfarë rrethanash konkrete, me argumente dhe prova se GOE i rekomanduar për kontratë nuk ka plotësuar kriteret e përzgjedhjes si dhe kriterin e dhënies te përcaktuar ne dosje tenderit. Prandaj duke u bazuar ne këto fakte dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë **nuk janë të qëndrueshëm.**

Përgjigje në pretendimi nr. 2

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues, AK nuk ka vlerësuar në pajtim me kërkesat që ka përcaktuar në Dosjes së Tenderit, FDT, pika 9.1 & 9.2, Kërkesa mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale numër 1. Grupi i Operatorëve Ekonomik të cilat janë shpallë fitues nuk kanë ofruar dëshmi të mjaftueshme se kanë përfunduar me sukses furnizime të natyrës së ngjashme për tri vitet e fundit në vlerë prej 3,000,000.00 €. Anëtari i grupit të konzorciumit MADEKOS, në referencat e tij ka ofruar produkte medicionale dhe pajisje medicionale, sic edhe është veprimtaria e tij. Referuar një vendimi të AK të datës 20.04.2021 të një njoftimi mbi vendimin e AK-së, shihet se AK-ja ka vepruar në veprim kontradiktor ndaj veprimeve të veta. Në këtë vendim shihet qartë se po e njëjta kompani, MADEKOS, me një aktivitet të njëjtë të prokurimit "Furnizim me inventar zyrtar dhe shkollor", shihet se është eliminuar për shkak se nuk i janë pranuar referencat medicionale, apo inventari mendicional. (gjeni bashkangjitur dëshminë). Po ashtu "Wood Coporation" në dokumentacionin e bashkangjitur si dëshmi e furnizimeve të ngjashme shihet se një referencë në vlerë prej 70,000.00 € është dëshmuar dy herë, duke vënë në lajthitje AK-në.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, bazuar ne dosjen e tenderit, OE ankues ne këtë pretendim ankimore ka përshkruar duke ofruar prova nga një aktivitet tjetër te viti 2021 (*sepse secili aktivitet i prokurimit është unik ne vetvete dhe nuk mund te krahasojmë apo te thirremi në një AP tjetër duke ngritur pretendim dhe krahasuar duke nxjerr parallel,*), mirëpo nuk ka specifikuar konkretisht cilat janë ato kontrata apo/ose referenca qe anëtari i grupit te OE nuk arrin ti plotësoj apo edhe nuk mund te pranohen si kontrata apo/ose referenca te ngjashme (*pretendimet ankimore duhet te jene te sakte, konkrete, te sakta, te qarta; bazuar ne bazuar ne* ***nenin 109 të LPP-së*** *si dhe nenit* ***64.2 te Rreg. Nr. 001/2022 për PP***), po ashtu OE ankues nuk ka specifikuar se për cilin Lot parashtron ankese, gjë qe ESH e ka te pa mundur te dije se çka ka dashtë te thotë apo ke menduar OE ankues dhe për cilat kontrata apo referenca sipas datës, vlerës, apo edhe nr. Prokurimit, pasi qe aty janë disa dhe ESH nuk mund te nxjerr një konstatim bazuar ne përshkrimin sikurse me larte nga OE ankues cili nuk është i qartë, i saktë dhe konkret. Prandaj duke u bazuar ne këto fakte dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë **nuk janë të qëndrueshëm.**

Përgjigje në pretendimi nr. 3

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues, AK po ashtu nuk ka vlerësuar në pajtim me kërkesat që ka përcaktuar në Dosjes së Tenderit, FDT, pika 9.1 & 9.2, Kërkesa mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale numër 2. Citoj: "Dëshmia 2 Katalogu për produktet qe oferton - Katalogu duhet të jetë i sakët për produktet që ofertoni. Nuk lejohet të ketë opsione si minimum apo duhet të ketë..., pra nuk mund të shfrytëzohet Aneksi 1 i dosjes së tenderit si katalog por duhet të ofrohet katalog që përfshinë të gjitha specifikat e produktit të cilin e ofroni". Po të njëjtit së bashku me ofertë në kundërshtim më kërkesën 2 të pikës 9.1 & 9.2 të FDT-së, kanë dorëzuar të nënshkruar dhe vulosur edhe specifikimin teknik edhe katalogun, kërkesë kjo e ndaluar nga AK-ja.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, bazuar ne dosjen e tenderit, nënshkrimi dhe vulosja nga OE e Aneksit 1 te FDT-se, plotëson kërkesën 3.1 te FDT-së, është ekuivalente me deklaratën për specifikim teknik dhe nuk është ne kundërshtim me kriteret e përzgjedhjes, aneksin 1 te FDT-se si dhe kriterin e dhënies se kontratës, gjithashtu, AK ka specifikuar kërkesat mbi mundësit teknik dhe profesional lidhur me katalogun për artikujt e specifikuar ne aneksin 1 te FDT-së, dhe nënshkrimi dhe vulosja e aneksit 1 te FDT-së nuk e bën OE te pa përgjegjshëm duke marr për baze dosjen e tenderit si dokument themelor për përgatitjen e tenderëve nga operatoret ekonomik. Prandaj duke u bazuar ne këto fakte dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë **nuk janë të qëndrueshëm.**

Përgjigje në pretendimi nr. 4

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues, në katalog shihet që disa nga pozicionet nuk janë të harmonizuara fotot me përshkrim, si dhe tek pozicioni 35 është përdorë "dhe të ketë", gjë që është e ndaluar si shprehje nga vet AK-ja. Po ashtu tek pozicioni 1, 2, 3, 4, 5, dhe 6 mungon titulli i pozicionit sipas specifikacionit teknik, lidhur me këtë procedure tenderuese, kërkojmë qe AK-ja të bëjë anulimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues dhe ta kthej lënden në rivlerësim – rivendosje.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, bazuar ne ankesën e OE ankues pran OSHP-se (edhe kërkesën për rishqyrtim pran AK), ku OE ankues nuk ka precizuar dhe saktësuar se për cilin nga Lot-et (Lot 1 apo Lot 3 – kjo nuk është vërtetuar as ne fletëpagesë për sigurim te ankese) ka ngritur pretendimet, pasi qe OE i rekomanduar për kontrate është rekomanduar për dhënie te kontratës për Lot 1 dhe Lot 3 dhe i cili ka dorëzuar 2 (dy) katalog te ndryshme (te ndare për lot 1 dhe për lot 3) andaj, eksperti shqyrtues e ka te vështirë te nxjerr një përfundim, mirëpo po përpiqemi te i analizoj dhe hulumtoj te dy (2) katalogë lidhur me pikat ku janë ngritur pretendimet, nëse i referohemi katalogut për Lot 3 pozicioni 35 (pasi qe tek Lot 1 nuk ka fare pozicion 35) fjale "dhe te këtë" nuk ekziston dhe duke marr për baze se përshkrimi i pretendimeve është shumë i paqartë, po ashtu thinja po citoj: "ne katalog shihet qe disa nga pozicionet nuk janë te harmonizuar fotot me përshkrim" gjithashtu pretendimi po citoj: "pozicioni 1, 2, 3, 4, 5, dhe 6 mungon titulli i pozicionit sipas specifikacionit Teknik" krejt këto pretendim janë jo te qarta, jo te sakta, dhe jo konkrete, ashtu siç obligon nenin***64.2 te Rreg. Nr. 001/2022 për PP,*** dhe pas shqyrtimit dhe analizimi te katalogut te dorëzuar nga OE i rekomanduar për dhënie te kontratës nuk mund te konstatohen këto pretendim te OE ankues, sepse katalogu është ne përputhje me kërkesat dhe kriteret e përcaktuar ne dosje te tenderit te përcaktuara nga AK (*përshkrimi teknik duhet te plotësohet dhe përderisa është plotësuar nuk është kërkuar te ceket titulli*).Prandaj duke u bazuar ne këto fakte dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë **nuk janë të qëndrueshëm.**

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, AK – komisioni i vlerësimit (lidhur me pretendimet e OE ankues), **ka respektuar nenin 7 dhe 59 të LPP-së**, andaj **Është përgjegjësi, dhe në diskrecion të Autoritetit Kontraktues, respektivisht komisionit të vlerësimit – ZPP,** që procesi i vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të behet ne harmoni te plote me dispozitat ligjore te LPP-se, ne këtë aktivitet te prokurimit, ne mënyrë qe të

respektohen kërkesat e përzgjedhjes, specifikimet teknike Aneksi 1 ne dosje te tenderit si dhe te respektohen kriteret e dhënies.

Eksperti shqyrtues sqaron, se autoritetet kontraktues janë te obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike te përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marr në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, ashtu siç parashihet në **nenin 6 të LPP-së**, autoriteti kontraktues duhet te këtë ne konsideratë edhe **nenin 1 të LPP-së**, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është te siguroj mënyrën më efikas, më transparent dhe më të drejt të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në faktet, sqarimet e lartpërmendura dhe te gjeturat tjera ne këtë raport, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues **refuzohet si e pa-bazuar**, (*për arsyen që u cek tek përgjigja në pretendimet si më lartë*) dhe *të njëjtin tender per* ***Lot 1, dhe Lot 3*** *rekomandojmë që të* ***mbete në fuqi vendimi i AK*** *lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.*

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **Agjencia Qendrore e Prokruimit**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **PRIME CORPORATION L.L.C.**

Sahit Beqiri